

La déclaration sur la famille : des paroles venant de Dieu

Par Ronald A. Rasband
du Collège des douze apôtres

Proklamata mbi Familjen – Fjalë nga Perëndia

Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Conférence générale d'octobre 2025

La déclaration est d'origine divine. Nous devons donc la traiter avec le respect que méritent les paroles de Dieu.

Cette conférence générale d'octobre 2025 marque le trentième anniversaire de la publication de « La famille, déclaration au monde ». Par dessein divin, cette déclaration, reçue par révélation, a été rédigée pour « sauvegarder et [...] fortifier la famille dans son rôle de cellule de base de la société ».

Nous faisons tous partie d'une famille, que nous soyons mère, père, fille, fils, petit-enfant, grand-parent, tante, oncle, frère, sœur ou cousin. Plus important encore, selon la déclaration, chacun de nous est « un fils ou une fille d'esprit aimé de parents célestes [qui possède] une nature et une destinée divines ».

Quand j'ai été appelé au saint apostolat en 2015, on m'a dit ceci : « Désormais, cette déclaration t'appartient. » Puis, en désignant les mots « Conseil des douze apôtres » dans le titre, la personne a ajouté : « Ton nom est là. Imprègne-t'en et enseigne-la comme si c'était la tienne. »

Que j'aime la déclaration sur la famille ! De l'Afrique à l'Australie, j'ai témoigné à travers le monde du rôle de la famille dans le plan éternel de Dieu. La déclaration est d'origine divine. Nous devons donc la traiter avec le respect que méritent les paroles de Dieu.

Frères et sœurs, comme je l'ai dit à cette chaire lors d'une conférence générale passée, souvenez-vous que « les mots sont importants ».

La déclaration est au cœur de nos croyances. Je vais vous raconter dans quelles circonstances elle a été écrite.

Proklamata ka një origjinë hyjnore, prandaj duhet ta trajtojmë me nderimin që meritojnë fjalët nga Perëndia.

Kjo konferencë e përgjithshme e tetorit 2025 shënon 30-vjetorin e shpalljes së dokumentit “Familja: Një Prokamatë drejtuar Botës”. Sipas qëllimit hyjnor, kjo prokamatë, me fjalët e saj të zbulesës, u krijua për të “ruajtur dhe forcuar familjen si njësi themelore e shoqërisë”.

Çdo njeri i përket një familjeje, pavarësisht nëse është një nënë, baba, bijë, bir, nip ose mbesë, gjysh ose gjyshe, teto, ungj, vëlla, motër apo kushëri. Më e rëndësishmja, secili prej nesh është, sikurse shpall proklamata, “një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë ... [me] një natyrë dhe destinacion hyjnor”.

Kur u thirra në detyrën e shenjtë të Apostullit në vitin 2015, m'u dha këshilla: “Kjo prokamatë tani është e jotja. Emri yt [duke treguar me gisht drejt fjalëve ‘Këshilli i Dymbëdhjetë Apostujve’ në titull] është pikërisht këtu. Ndieje atë dhe jepe mësim sikur të ishte e jotja.”

Më pëlqen shumë proklamata mbi familjen. Kam dëshmuar anembanë botës që nga Afrika në Australi dhe kudo tjetër midis tyre, për rolin e familjes në planin e përjetshëm të Perëndisë. Proklamata ka një origjinë hyjnore, prandaj duhet ta trajtojmë me nderimin që meritojnë fjalët nga Perëndia.

Mbajeni mend, vëllezër e motra, siç e thashë në konferencën e përgjithshme të mëparshme nga kjo foltore: “Fjalët kanë rëndësi”.

Lejomëni t'ju jap ca informacion historik rreth prokamatës si një mesazh thelbësor i asaj që besojmë.

En 1994, un an avant la présentation de la déclaration, le Collège des douze apôtres a discuté de l'éloignement croissant de la société et des gouvernements des lois de Dieu concernant la famille, le mariage et l'identité sexuelle. Le président Nelson a expliqué plus tard : « Ce n'est pas là tout ce que nous avons vu se profiler. Nous avons vu les efforts entrepris par diverses communautés pour éliminer toutes les normes et les limites relatives à l'activité sexuelle. Nous avons vu la confusion des sexes. Nous avons vu tout cela arriver. »

Les Douze ont décidé de rédiger un document, une déclaration officielle, qui résumait la position de l'Église sur la famille. Cette année-là, ces apôtres, des voyants appelés de Dieu, ont préparé une déclaration sur la famille. Dallin H. Oaks a raconté qu'à l'aide de la prière, ils se sont tournés vers le Seigneur pour savoir « ce qui devait être dit et [...] la manière de le dire ». Ils ont présenté la déclaration à la Première Présidence, constituée de Howard W. Hunter, Gordon B. Hinckley et Thomas S. Monson, pour qu'elle l'examine.

Quelques mois plus tard, en mars 1995, le président Hunter est décédé et le président Hinckley est devenu le quinzième président de l'Église. La déclaration était alors entre ses mains. Quel serait le bon moment pour faire cette déclaration à l'Église? Ce moment est arrivé six mois plus tard.

Quelques jours avant la réunion générale des femmes du 23 septembre, qui précédait la conférence générale, le président Hinckley et ses conseillers ont tenu conseil avec la présidence générale de la Société de Secours. Les sœurs, comme les apôtres, avaient réfléchi aux préoccupations qui touchaient les femmes et la famille. Il a été décidé d'axer la réunion à venir sur la famille.

Il était prévu que le président Hinckley s'adresse aux femmes lors de la réunion. Il avait médité sur le sujet de son discours. Au cours de la discussion, il a mentionné le titre de la déclaration au monde sur la famille, nouvellement rédigée et qui n'avait pas encore été rendue publique. Cette réunion des femmes était-elle le bon cadre pour faire une déclaration décisive sur la famille?

Elaine Jack, alors présidente générale de la Société de Secours, a expliqué plus tard : « À ce moment-là, nous ne savions pas ce qu'était

Në vitin 1994, një vit përpara se të paraqitej proklamata, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve diskutoi se si shoqëria dhe qeveritë po largoheshin nga ligjet e Perëndisë për familjen, martesën dhe gjininë. “Por ai nuk ishte fundi i asaj që pamë”, – shpjegoi më vonë Presidenti Rasëll M. Nelson. “Ne mund të shihnim përpjekjet e komuniteteve të ndryshme për t’i hequr të gjitha standardet dhe kufizimet në aktivitetin seksual. Ne pamë pështjellimin e gjinive. Ne mund t’i shihnim të gjitha këto të ndodhnin.”

Të Dymbëdhjetët vendosën që të përgatitnin një dokument, një proklamatë zyrtare, duke përmbledhur qëndrimin e Kishës mbi familjen. Gjatë atij viti, këta Apostuj, shikues të thirrur nga Perëndia, përgatitën një deklaratë rreth familjes. Presidenti Dallin H. Oaks kujtoi se ata plot lutje iu drejtuan Zotit për “atë që duhej të thoshi[n] dhe mënyrën se si duhej ta thoshi[n]”. Ata ia paraqitën atë Presidencës së Parë: Presidentëve Howard W. Hunter, Gordon B. Hinkli dhe Tomas S. Monson, që ta shqyrtonin.

Vetëm pak muaj më vonë, në mars 1995, Presidenti Hunter ndërroi jetë dhe Presidenti Hinkli u bë Presidenti i 15-të i Kishës. Proklamata ishte tani në duart e tij. Kur do të ishte koha e duhur që t’i bëhej kjo deklaratë Kishës? Ajo kohë erdhi gjashtë muaj më vonë.

Disa ditë përpara mbledhjes së përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës së 23 shtatorit, që i parapriu konferencës së përgjithshme, Presidenti Hinkli dhe këshilltarët e tij u takuan në këshill me Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës. Motrat, si Apostujt, kishin kohë që po i peshonin shqetësimet rreth grave dhe familjeve. Ato e kishin përqendruar te familjet mbledhjen që po afrohej.

Ishte planifikuar që Presidenti Hinkli t’u drejtohej grave në atë grumbullim. Ai kishte përsiatur për drejtimin e bisedës së tij. Teksa diskutimi përparonte, ai iu drejtua me titull dokumentit të sapokrijuar, por ende jo publik: “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”. A ishte kjo mbledhje e grave mjedisi i duhur për ta bërë deklaratën vendimtare rreth familjes?

Presidentja e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, Ilajn Xhek më vonë shpjegoi: “Nuk e dinim se çfarë ishte proklamata mbi familjen në

la déclaration sur la famille. Nous pouvions le deviner par son titre et nous sentions que tout message sur la famille [...] serait bénéfique. [...] J'étais convaincue que les membres du Collège des Douze recevaient des révélations. »

Ce samedi-là, la réunion de la Société de Secours a été historique. Avant de présenter la déclaration, le président Hinckley a prononcé ces paroles importantes : « Avec tous les raisonnements spécieux qui sont présentés comme des vérités, avec toutes les tromperies à propos des principes, avec toutes les incitations à nous laisser gagner peu à peu par la souillure du monde, nous nous sentons poussés à lancer un avertissement [et à réaffirmer] les principes, la doctrine et les pratiques relatifs à la famille que les prophètes, voyants et révélateurs de notre Église ont énoncés à maintes reprises tout au long de son histoire. »

Il a ensuite lu la déclaration dans son intégralité. Comme le Seigneur l'a déclaré : « Que ce soit par ma voix ou par la voix de mes serviteurs, c'est la même chose. »

La déclaration énonce : « La famille est ordonnée de Dieu. » Que j'aime la clarté de cette phrase ! Cette déclaration est un appel à traverser la condition mortelle en gardant toujours à l'esprit la divinité qui est en nous et l'avenir éternel qui nous attend. Le président Nelson a enseigné : « Vous êtes littéralement des enfants d'esprit de Dieu. [...] Ne vous y trompez pas : votre potentiel est divin. Si vous cherchez diligemment, Dieu vous donnera un aperçu de ce que vous pouvez devenir. »

Lorsqu'elle a été présentée, la déclaration n'était pas en accord avec l'opinion de beaucoup dans le monde. C'était le cas à l'époque. C'est toujours le cas aujourd'hui. Certains s'opposent à ce qu'elle affirme sur la famille, le mariage et le genre. D'autres suggèrent que l'Église devrait retirer, réviser ou même mettre de côté la déclaration.

Chers frères et sœurs, comme l'a dit le président Hinckley, cette déclaration sur la famille est doctrinale. Les principes qu'elle énonce ne sont pas en contradiction avec les voies du Seigneur et son chemin des alliances, mais en parfaite harmonie avec eux. Les enseignements que contient la déclaration ont été révélés par notre Seigneur Jésus-Christ à ses apôtres, à l'époque et aujourd'hui. C'est son Église. C'est lui qui a établi les vérités selon lesquelles nous vivons.

En réfléchissant à la déclaration, certains

atë kohë. ... [N]e mund ta kuptonim nga titulli, por e ndiem se çdo gjë mbi familjen ... do të ishte një gjë e mirë. ... U ndjeva shumë mirë që kishte anëtarë të Kuoromit të Të Dymbëdhjetëve që po merrnin zbulesë.”

Mbledhja e Shoqatës së Ndihmës atë të shtunë qe historike. Presidenti Hinkli e paraqiti proklamata mbi familjen me këto fjalë të rëndësishme: “Me kaq shumë sofizëm që jepet si e vërtetë, me kaq shumë mashtrime lidhur me standardet e vlerat, me kaq shumë joshje dhe tërheqje që dalëngadalë të njollosemi si bota, ne e kemi ndier që të lajmërojmë dhe paralajmërojmë ... për standardet, doktrinat dhe praktikatat që lidhen me familjen, të cilat profetët, shikuesit dhe zbuluesit e kësaj Kishe i kanë përsëritur vazhdimisht gjatë gjithë historisë së saj”.

Ai e lexoi më pas proklamata tërësisht. Siç ka thënë Zoti: “Qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj”.

Proklamata thotë: “Familja shugurohet nga Perëndia”. Më pëlqen shumë qartësia e këtij deklarami. Proklamata është një thirrje për ne që të jetojmë në vdekshmëri kurdoherë të vëmendshëm ndaj hyjnisë brenda nesh dhe të ardhmes së përjetshme që shtrihet përpara nesh. Presidenti Nelson dha mësim: “Ju jeni në mënyrë të mirëfilltë fëmijë shpirtërorë të Perëndisë. ... Mos bëni gabim në lidhje me këtë: Potenciali juaj është hyjnor. Me kërkimin tuaj të zellshëm, Perëndia do t'ju japë grimca të personit që mund të bëheni.”

Kur u paraqit, proklamata nuk përputhej me pikëpamjet e shumë njerëzve në botë. As atëherë. As tani. Ka nga ata që ndihen të fyer nga deklarata mbi familjen, martesën dhe gjininë. Disa sugjerojnë që Kisha ta tërheqë mbrapsht, ta rishikojë ose madje ta vërë mënjanë proklamata.

Kjo proklamata mbi familjen është, sikurse shpalli Presidenti Hinkli, doktrinë, vëllezërit e motrat e mia të dashura. Parimet nuk janë në mospërputhje, por përsosurisht në përputhje me udhët e Zotit dhe shtegun e Tij të besëlidhjeve. Mësimet e proklamatës iu zbuluan nga Zoti ynë, Jezu Krishti, Apostujve të Tij atëherë dhe tani. Kjo është Kisha e Tij; Ai i ka themeluar të vërtetat sipas të cilave jetojmë.

Disa prej jush mund të reflektojnë për

d'entre vous se disent peut-être : « Elle ne convient pas à ma situation. » « Elle manque d'empathie. » « Ma famille ne ressemble pas à cela. » « Je ne m'y reconnais pas. »

Aux personnes inquiètes à ce sujet, je dis : sachez que vous êtes un enfant de parents célestes que vous faites partie de la famille de votre Père céleste. Personne ne vous connaît mieux que lui ni ne se soucie plus profondément de vous. Tournez-vous vers lui, déversez-lui votre cœur, ayez confiance en lui et en ses promesses. Vous avez une famille en la personne de votre Sauveur, Jésus-Christ, qui vous aime. Il est venu sur terre pour expier nos péchés et porter le fardeau de nos fautes et de nos jours les plus sombres. Il comprend ce que vous traversez et ressentez. Tournez-vous vers lui et ayez confiance qu'il enverra le Saint-Esprit pour vous accompagner, vous élever et vous guider. Ressentez leur amour « qui se répand dans le cœur des enfants des hommes [...] ; c'est la plus désirable de toutes les choses [...] et la plus joyeuse pour l'âme ».

Tous les apôtres du seigneur vous aiment tendrement. Nous prions pour vous et recherchons les directives du Seigneur à votre égard. Restez avec nous. Vous vivez à une époque difficile où l'adversaire cherche à vous assujettir. Ne vous laissez pas entraîner. Et si vous l'avez été, revenez. Nos bras, ainsi que ceux d'autres personnes qui vous aiment, vous sont ouverts.

La déclaration stipule que « les parents ont le devoir sacré d'élever leurs enfants dans l'amour et la droiture ». Le Livre de Mormon offre un deuxième témoignage de cette vérité. Au premier verset de son premier chapitre, nous lisons : « Moi, Néphi, étant né de bons parents. » Combien d'entre nous ont commencé, et recommencé encore et encore, le Livre de Mormon, au point que ces mots sont devenus gravés dans notre esprit ? Gravez-les dans votre cœur.

L'une de mes phrases préférées de la déclaration est celle-ci : « On a le plus de chances d'atteindre le bonheur en famille lorsque celle-ci est fondée sur les enseignements de [...] Jésus-Christ. »

Qui ne souhaite pas être heureux ?

Et quels sont les enseignements de Jésus-Christ ? De nouveau, dans la déclaration : « La foi, la prière, le repentir, le pardon, le respect, l'amour, la compassion, le travail et les divertissements sains. »

Qui ne verrait pas sa vie s'améliorer en

proklamaten dhe te thonë: “Kjo nuk funksionon me për mua”. “Duket e pandjeshme.” “Familja ime nuk është ashtu.” “Nuk e gjej veten.”

Për ata që kanë shqetësime, dijeni se jeni fëmijë i prindërve qiellorë, pjesë e familjes së Atit tuaj Qiellor. Askush nuk ju njeh më mirë ose interesohet më thellësisht për ju sesa Ai. Drejtojuni Atij, derdhjani zemrën Atij, mirëbesojini Atij dhe premtimeve të Tij. Ju keni familje te Shpëtimtari juaj, Jezu Krishti i cili ju do. Ai erdhi në tokë që të shlyente për mëkatet tona dhe për të mbajtur barrët e gabimeve tona dhe të ditëve tona shumë të këqija. Ai e kupton se me çfarë po përballeni dhe se si ndiheni. Drejtojuni Atij, mirëbesoni se Ai do të dërgojë Frymën e Shenjtë që të jetë me ju, t'ju lartësojë shpirtërisht dhe t'ju udhërrëfjë. Ndiejeni dashurinë e Tyre që “derdhet në zemrat e fëmijëve të njerëzve; ... ajo është më e dëshirueshmja mbi të gjitha gjërat ... dhe më e gëzueshmja për shpirtin”.

Të gjithë Apostujt e Zotit ju duan fort. Ne lutemi për ju dhe kërkojmë udhërrëfim të Zotit për ju. Qëndroni me ne. Ju jetoni në kohë sfiduese kur kundërshtari përpiket t'ju bëjë të vetin. Mos u largoni prej nesh. Dhe nëse jeni larguar, kthehuni. Krahët tanë shtrihen drejt jush, ashtu si do të shtrihen krahët e njerëzve të tjerë që ju duan.

Proklamata shpall: “Prindërit kanë një detyrë të shenjtë për t'i rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi”. Libri i Mormonit siguron një dëshmi të dytë për këtë të vërtetë. Në vargun e parë të kapitullit të parë, lexojmë: “Unë, Nefi, duke qenë i lindur nga prindër të mirë”. Sa prej nesh e filluan Librin e Mormonit dhe e filluan përsëri e përsëri dhe, në atë proces, i ngulitën ato fjalë në mendje? Ngulitini ato përmendsh.

Një parim që mësojmë nga proklamata e familjes është ky: “Lumturia në jetën familjare ka më shumë të ngjarë të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Zotit Jezu Krisht”.

Kush nuk dëshiron të jetë i lumtur?!

Dhe cilat janë mësimet e Jezu Krishtit?

Përsëri, te proklamata: “Besimi..., lutj[a], pendimi, falj[a], respekti, dashuri[a], dhembshuri[a], pun[a] dhe aktivitetet... të shëndosha argëtuese”.

Jeta e kujt nuk do të jetë më e mirë duke i

mettant en pratique ces principes essentiels ?
Aucun d'entre nous ne les mettra parfaitement en application, mais nous pouvons toutefois suivre ces sages paroles du président Hinckley : « Faites de votre mieux. »

Dans la déclaration, nous lisons : « Le père doit présider dans l'amour et la droiture » et « la mère a pour première responsabilité d'élever ses enfants ». Présiderne veut pas dire dominer et éleverne désigne pas un rôle secondaire. Dieu a donné aux hommes et aux femmes des rôles différents, mais égaux, essentiels et complémentaires.

Je vais vous raconter une histoire personnelle.

Ma femme et moi avons appris à mieux travailler en partenaires égaux après qu'un jour j'ai décidé de prendre une décision importante sans la consulter. Cela l'a surprise, l'a prise au dépourvu et l'a placée dans une situation très difficile. Quelque temps après, elle a posé la main sur mon épaule et m'a dit avec fermeté : « Ron, s'il te plaît, ne me fais plus jamais ça. » Depuis ce jour, nous avons pratiquement toujours été en accord.

Nous trouvons ceci dans la déclaration sur la famille : « Le père et la mère ont l'obligation de s'aider en qualité de partenaires égaux. »

« Égaux » est un mot important. Au fil des années, sœur Rasband et moi avons travaillé ensemble sur ce que la déclaration décrit comme nos « responsabilités sacrées », nous avons façonné notre mariage sous un joug d'égalité. Maintenant que nos enfants sont tous mariés, sœur Rasband et moi-même continuons de leur donner des conseils, ainsi qu'à leurs conjoints, sur la manière d'être des partenaires égaux.

Lorsque nous vivons les yeux fixés uniquement sur la gloire de Dieu, nous nous respectons les uns les autres et nous nous soutenons mutuellement. Ces modèles divins de justice conduisent à la stabilité dans notre vie, dans notre famille et dans la société.

Notre Père céleste a donné la déclaration sur la famille afin de nous aider à revenir à lui, à apprendre, et à être remplis d'amour, de force, de détermination et de compréhension éternelle. De toute mon âme, je vous supplie de rester proches de lui et de son Fils bien-aimé. Je vous promets que si vous le faites, l'Esprit vous inspirera, vous guidera et vous aidera à ressentir dans votre

zbatuar këto parime kyç? Askush prej nesh nuk do të veprojë me përsosuri; por mund të ndjekim fjalët e urta të Presidentit Hinkli: “Bëni më të mirën që mundeni”.

Ne lexojmë në proklamatë: “Etërit duhet t[ë] kryesojnë ... me dashuri e drejtësi” dhe se “[n]ënat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre”. Kryesojnë nuk do të thotë mbizotërojnë dhe edukiminuk do të thotë një rol i dorës së dytë. Përndia u ka dhënë burrave dhe grave role të ndryshme, por të barabarta dhe thelbësore që plotësojnë njëri-tjetrin.

Më lejoni të tregoj një histori nga vetja.

Bashkëshortja ime dhe unë mësuam të punonim më mirë që të ishim bashkëpunëtorë të barabartë pas një dite kur unë vendosa të merrja një vendim të rëndësishëm pa u këshilluar me të. Veprimi im e habiti, e gjeti të papërgatitur dhe e vuri në një gjendje shumë të vështirë. Më pas, ajo m'i vuri duart mbi supet dhe me vendosmëri tha: “Ron, të lutem, mos ma bëj më kurrë atë gjë”. Që atëherë, pothuajse gjithmonë kemi qenë në një mendje.

Ne gjejmë te proklamata për familjen: “[E]tërit dhe nënat kanë detyrimin ta ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë”.

Të barabartë është një fjalë që ka rëndësi. Përgjatë viteve, teksa Motra Rasband dhe unë kemi punuar së bashku në ato që proklamata i përshkruan si “përgjegjësi [të tona] të shenjta”, ne i kemi dhënë formë një martesë me një zgjedhje të përbashkët. Teksa secili prej fëmijëve tanë është martuar, Motra Rasband dhe unë kemi vazhduar ti këshillojmë ata dhe bashkëshortet e bashkëshortët e tyre se si të jenë partnerë të barabartë.

Kur jetojmë me sy të drejtuar vetëm te lavdia e Përndisë, ne e respektojmë njëri-tjetrin dhe e përkrhim njëri-tjetrin. Ato modele hyjnore të drejtësisë çojnë drejt qëndrueshmërisë në jetën tonë individuale, në familjet tona dhe në shoqëri.

Ati ynë në Qiell e ka dhënë proklamatën mbi familjen për të ndihmuar që të na udhërrëfjë për në shtëpi tek Ai, për të na ndihmuar të mësojmë dhe të mbushemi me dashuri, forcë, qëllim dhe kuptueshmëri të përzetshme. Me gjithë shpirt, ju përgjerohem që të jetoni pranë Tij dhe Birit të Tij të Dashur. Ju premtoj se, kur ta bëni këtë, Shpirti do t'ju frymëzojë, udhërrëfjë dhe ndihmojë të

cœur la paix promise qui « surpasse toute intelligence ». Au nom de Jésus-Christ. Amen.

ndieni në zemrën tuaj paqen e premtuar prej Tyre, e cila “ia tejkalon çdo zgjuarsie”. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.